

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ALBANIA MACO DENTAL CARE” SHPK

Ortakët themelues:

- **Z. Jose Felix Conte**, shtetas italian, i datëlindjes 28/11/1967, lindur në Monte Grande-Buenos Aires (ARG) , banues ne Buccino, Contrada Isca Del Mulino, Salerno, Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës italiane Nr. YA7552193C

dhe

- **Z. Luca Villani**, shtetas italian, i datëlindjes 30/01/1981, lindur në Nocera Inferiore (SA) dhe banues ne Rrugen San Giacomo Nr.15, Cetara, Salerno, Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës italiane Nr. YC1828934.

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë 15.10.2024, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “ALBANIA MACO DENTAL CARE” shpk.

Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “ALBANIA MACO DENTAL CARE” shpk ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ALBANIA MACO DENTAL CARE” shpk, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Donika Kastrioti 3, Kisha Apostolike e Re, Hyrja 2, Kati i 1, Apt.1, Nr.1, Tirane, Shqiperi.

3.2. Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: Prodhimi dhe tregtimi i protezave dentare, ortopedike dhe ndihmëse, prodhimi i implanteve dentare, prodhimi i pajisjeve elektro-

mjekësore, pajisjeve mjekësore dhe instrumenteve për stomatologji dhe trajtimet sipërfaqësore të implanteve dentare dhe protezave ortopedike.

Organizimi i laboratorëve dentar, praktika dentare dhe klinikave dentare për trajtimin, profilaksinë dentare dhe maksilofaciale, duke përdorur personel të kualifikuar në përputhje me legjislacionin aktual.

Organizimi i kurseve profesionale për formimin profesional dhe për dhënien e krediteve të trajnimit, me autorizimin e urdhrave dhe/ose organeve dhe/ose drejtuesve.

Organizimi i konferencave, takimeve, eventeve, panairove dhe eventeve në përgjithësi: tregti me shumicë dhe pakicë, tregti elektronike, import-eksport në Shqipëri dhe jashtë vendit të artikujve mjekësorë dhe ortopedikë, proteza dentare dhe implante dentare dhe aksesorë të ngjashëm, pajisje dhe spitale, kujdes shëndetësor. artikuj.

Aktivitete në fushën e pasurive të paluajtshme, vlerësimi i pasurive të paluajtshme, angazhimi në tregtimin me shumicë dhe pakicë të çdo lloj prone dhe hapja e dyqaneve, degëve apo zyrave përfaqësuese brenda dhe jashtë territorit shqiptar për arritjen e objektivit të biznesit.

Menaxhimi dhe administrimi i pronave dhe objekteve.

Investime në fushën e ndërtimit dhe tregtisë brenda dhe jashtë vendit të pasurive të paluajtshme.

Administrimi i godinave në ndërtesa brenda dhe jashtë territorit kombëtar.

Ndërmjetësimi për shitjen, blerjen ose dhënien me qira të pasurive të paluajtshme ndërmjet personave fizikë, juridikë privatë dhe publikë, si dhe nga shteti, si dhe çdo veprim tjetër juridik në lidhje me pasuritë e paluajtshme.

Veprimtari në fushën e konsulencës teknike për të gjitha fushat e ekonomisë, si dhe çdo veprimtari tjetër funksionale për qëllimin e shoqërisë dhe që nuk ndalohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Kryerja e studimeve ekonomiko-financiare, konsulence variabile dhe administrative.

NENI 5 ***Kohëzgjatja***

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6 ***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

Shoqëria tregtare “ALBANIA MACO DENTAL CARE” shpk mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7 ***Përgjegjësia e Ortakëve***



Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “ALBANIA MACO DENTAL CARE” shpk dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ALBANIA MACO DENTAL CARE” shpk është 100.000 (njeqindmije) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortakët e ndarë në 2 pjesë:

Z. Jose Felix Conte – 1 kuotë - 50% me vlere 50.000 (pesëdhjetë mije lek)

Z. Luca Villani – 1 kuotë - 50% me vlere 50.000 (pesëdhjetë mije lek)

NENI 9

Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë është **Z. Jose Felix Conte**.

NENI 11

Sekretit tregtar


Ortaku, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë “ALBANIA MACO DENTAL CARE” shpk përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

NENI 12

Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t’i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES



Jose Felix Conte

JOSÉ FELIX CONTE *Jose Felix Conte*

Luca Villani

Luca Villani *Luca Villani*